



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “NAZMI RUSHITI”DIBËR.

Nr. 163 prot.

Peshkopi, më 17.03.2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
TIRANË

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, “Për nxitjen e punësimit:të ligjit nr.15/2017,datë 16.02.2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,të vendim të Këshillit të Ministrave nr. 554,datë 31.07.2019, “Për krijimin ,mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive datë si dhe Udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024 “ Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë,menaxhimin e burimeve njerëzore,përberjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”i ndryshuar.

Ofruesi publik i AFP - së - shkolla e mesme profesionale “ Nazmi Rushiti “ Dibër, ju njofton krijimin e vendit të lire : për pozicionin :

-Mësimdhënës të teorisë profesionale,Drejtimi Ekonomi Biznes,1(një mësimdhënës) në shkollën Bulqizë, me kohë të pjesshme (11 orë/javë)

A-Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

1 – Kriteret e përgjithshme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon ;

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon ;

- a) Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlefshme, në të njëjtën fushë me kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së, për të cilin/cilat po aplikon
- b) Të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

2-Dokumentet e aplikimit

Dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi
- c) kartën e identitetit;
- d) diplom
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- i) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm

- ✓ Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.
- ✓ Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda datës 27 . 03 . 2026

3.Vlerësimi i kandidatëve do të behet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759, datë 30.09.2024 “ Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përberjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit” i ndryshuar.

DREJTOR I KOMANDUAR

Meleq METHASANI

